



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE

PA1 Nr.08-213

8.8.2022

Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe paragrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së punës të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i zbardhur) (Nr. ynë ark.01-3732/1) datë 29.7.2019, Vendimin PA1 nr. 08-213 datë 29.7.2022 për heqjen e lejes së radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr. 08-81 datë 5.1.2015 dhe Konkluzionin me nr. ark. 02-3032/7 datë 8.8.2022, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 30-të mbajtur më 8.8.2022 miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KAPITOL FM SHPKNJP Shkup FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve
2. Ky aktvendim botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në uebfaqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim është përfundimtar.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale – LSHMAAV, leja e transmetimit për televizion ose radio pushon të vlejë në bazë të ligjit, me marrjen e lejes nga ana e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale – ASHMAA-së. Në pajtim me paragrafin (2) të nenit të cituar të ligjit, ASHMAA-ja do të fshijë radiodifuzerin nga regjistri i transmetuesit nëse leja pushon të vlejë në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV-së.

Këshilli i ASHMAA-së në seancën e 29-të mbajtur më 29.7.2022., në pajtim me Konkluzionin me nr. ark. 02-2964/2 datë 29.7.2022, miratoi Vendimin PA1 nr. 08-213 datë 29.7.2022 për marrjen e lejes të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr. 08-81 datë 5.1.2015, për shkak se pas dhënies së lejes ndodhën situata që paraqesin pengesa Ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë së tij – marrje të lejes së shfrytëzimit të radiofrekuencave të dhëna nga AKE-ja si kusht bazë për kryerjen e veprimtarisë – transmetim të shërbimeve programore në radio, në pajtim me nenin 82 paragrafi (1), nënparagrafi 5 të LSHMAAV-së.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lartë, dhe në bazë të nenit 18, paragrafi (1) nënparagrafi 20, nenit 23 paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV-së, në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së punës të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i zbardhur) nr. ark. 01-3732/1 datë 29.7.2019, Vendimin PA1 nr. 08-213 datë 29.7.2022 për marrjen e lejes së radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr. 08-81 datë 5.1.2015 dhe Konkluzionin me nr. ark. 02-3032/7 datë 8.8.2022, Këshilli i ASHMAA-së, në seancën e 30-të mbajtur më 8.8.2022, miratoi aktvendimin si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.

Dorëzuar:

- Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KAPITOL FM SHPKNJP Shkup;
- Drejtuesit të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KAPITOL FM SHPKNJP Shkup;
- Advokatit Sashko Pop-Angellov nga Shkupi, përfaqësues i Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KAPITOL FM SHPKNJP Shkup;
- Sektorit të mbështetjes informatike dhe të çështjeve të përgjithshme – Arkivit të ASHMAA-së;
- Sektorit të çështjeve juridike dhe të prokurimit publik;
- Sektorit të financa dhe të logjistikë;
- Të emëruarve në ASHMAA për udhëheqjen e PA1; dhe
- Agjencisë së Komunikim Elektronik të RMV-së.